



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PERGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 04.08.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE) **"SIRE-ALB " me NUIS M36415202E**

Adresa: Tiranë, Rruga ‘‘Fejzi Hizmo&Nexho Konomi’’, Njësia Strukturore TR/397 AP.D51

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) PO ☐ JO X

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Shërbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar

Numri i Procedurës: REF-52611-06-27-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: Projektim Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme

Fondi limit: 2.493.475 (Dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës: 30 (tri dhjetë) ditë.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 30.06.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : nr.34 datë 07 Korrik 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "SIRE-ALB " me NUIS M36415202E

Vlera : **2 189 793** (Dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. NOVATECH STUDIO me NUIS-L01717030C

Vlera : **2 189 484** (Dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. NET-GROUP me NUIS - L72023002P

Vlera : **2 138 254.24** (Dy milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e katër) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Bersant Ylli me NUIS- L94017201S; 20 % sipërmarrje

Vlera : **2 189 793** (Dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: MAGNA CHARTA me NUIS- L92318021H; 80 % sipërmarrje

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. NOVATECH STUDIO me NUIS-L01717030C

Për arsye se ky operator ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertës, nuk rezulton të ketë paraqitur :

Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. NET-GROUP me NUIS - L72023002P

Për arsye se ky operator ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertës, nuk rezulton të ketë paraqitur :

Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Bersant Ylli me NUIS- L94017201S; 20 % sipërmarrje

Për arsye se ky operator ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertës, nuk rezulton të ketë paraqitur :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik Bersant Ylli PF, në rastin konkret kemi një deklaratë angazhimi, të nënshkruar nga shoqëria "Desaret Company" sh.p.k, për mbështetjen e shoqërisë Bersant Ylli PF ku do të angazhohet që të mbështesë shoqërinë "Bersant Ylli PF sipas pikës në DST 2.3.2 për licencën në projektim Kat. i- Projektimi i ndriçimit rrugor,

shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive,porteve aeroporteve etj.

Subjekti “Desaret Company” sh.p.k., për këtë pikë licencë të kërkuar nuk ka deklaruar as ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe as ne deklaratën e angazhimit personelin inxhinierik qe do te angazhohet per plotesimin e kesaj pike licence,ne rastin konkret 1(nje) inxhinier elektrik duke mos plotesuar kerkesen e AK.

Nga ana tjetër , mbështetja e operatorit ekonomik Bersant Ylli PF mbi kapacitetin e operatorit ekonomik “Desaret Company” sh.p.k, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, bie ne kundërshtim me pikën 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se:“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik Bersant Ylli PF si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ndërkohë” rezulton të jetë mbështetur plotësisht te subjekti mbështetës “Desaret Company” sh.p.k i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit çfarë bie ndesh edhe e parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.

KVO gjykon se operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi pasi ai është mbështetur plotësisht te operatori ekonomik “Desaret Company” sh.p.k lidhur me Kapacitetin teknik pika 2.3.2 e DT.

OE/BOE me nënkontraktor

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: MAGNA CHARTA me NUIS- L92318021H; 80 % sipërmarrje

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë (OE"**SIRE-ALB "** **me NUIS M36415202E** Adresa:Tiranë, Rruga ‘‘Fejzi Hizmo&Nexho Konomi’’, Njësia Strukturore TR/397 AP.D51, se oferta e paraqitur me vlerë totale 2 189 793 (Dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh dhe **2 627 752** (Dy milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë me tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ‘‘Për Prokurimin Publik’’, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR